

Muhamet Tërnavë

KONTRIBUT ÇËSHTJES SË PRANISË DHE TË ASIMILIMIT TË VLLEHËVE NË KOSOVË NË SHEKUJT XIV — XVI

Termi *Vllah*, sllavisht *Vlah*, shumësi *Vlasi*, në kohën mesjetare, përfaqësonte popullatë romane të Gadishullit Ballkanik dhe të territoreve përreth tij. Ky term i përgjigjet plotësisht termit gjerman *Walh*.¹ Këso popullate romane, që në mesjetë quhej Vllahe, kishte edhe në territorin e sotëm të Kosovës gjatë tërë kohës mesjetare. Sipas mendimit të njerit nga njohësit e mirë të historisë mesjetare të popujve të Ballkanit, Jireçekut kjo popullatë romane, që më vonë në kohën e feudalizmit të zhvilluar (në distancën kohore në mes shekujve XII-XV), del ndër dokumente të shkruara me emrin *Vlah* (shumësi *Vlasi*), në territorin e Dardanisë, ishte e pranishme që në shek. VII.² Më vonë, sikurse edhe për shqiptarët ashtu edhe për vllahët në këtë trevë nuk kemi të dhëna historike për disa shekuj. Por, kjo kurrësesi nuk do të thotë se ata nuk ishin të pranishëm aty deri në gjysmën e dytë të shekullit. XII, kur përmenden në dokumentacionin e shkruar, në pjesën më të madhe në atë qirilik.

Popullatë Vllehe, në mesjetë, nuk kishte vetëm në trollin e sotëm të Kosovës, por edhe në vise të tjera rreth tij, e edhe më larg tij. Kështu, psh. prania e saj mund të dëshmohet në territorin e Serbisë, të Bregdetit Dalmatin, të Bregdetit të Malit të Zi dhe në viset e Bullgarisë së sotme.³

„Në viset malore në mes të Nishit dhe Sofjes elementi roman ishte gjithësesi vendas (...)”⁴

Mbi praninë e Vllehëve brenda Serbisë mesjetare ka të dhëna të shumta. Praninë e tyre, ndërkaq, jo vetëm në këtë territor, por edhe në tërë Ballkanin e trajtoi Silvin Dragomiri.⁵

¹ Mbi origjinën e termit Vllah shih: C. T a g l i v i n i, *Le origini delle lingue neolatine*, Bologne, 1959, 123-124.

² S. D r a g o m i r, *Vllahii din Nordul Peninsulei balcanice in evul mediu*, Bucarest, 1959, 11-15, B. Djurdjev, Ispisi iz deftera za Braničevo iz XV veka, 1467-1468, Istorijski glasnik, 98-98.

³ N. B e l d i c e a n u, *La region de Timok-Morava dans les documents de Mehmed II et de Selim I*, Revue des etudes roumaines, t. III-IV, Paris, 1957, 11-129.

⁴ Kështu mendon edhe K. Jireçeku

⁵ S. D r a g o m i r, *Les Roumains des Balkans au moyen age*, t. VIII, Bucarest, 1947; Shih edhe Dr. C u s t a v W e i n g a n d, *Die Aromunen*, I, Leipzig 1895, T h. C a p i d a n, *Aromanii*, Bucuressti, 1932.

Me pushtimet e Stefan Nemanjës dhe të pasardhësve të tij shteti Nemanjiças përfshiu edhe territoret në të cilat kishte Vllehë, të cilët përmenden mjaft shpesh në burimet serbe nga gjysma e dytë e shek. të XII e tutje. Mirëpo, burimet e ruajtura, kryesisht, kanë të dhëna mbi Vllehët në feudet kishtarë e mbi obligimet e tyre. Në bazë të këtyre burimeve del qartë se kishte Vllehë ushtarë dhe „qelatorë”. Gjithashtu bazuar në to hetohet se kishte Vllehë të zhupanëve të mëdhenj, të mbretërve dhe të perandorëve.⁶

Studjuesi i njohur Jireçeku hetoi me të drejtë se të gjithë Vllehët në kuadrin e shtetit Nemanjiças ishin të nënshtuar ndaj sundimtarit dhe përmes kartave të tij mund të bëheshin pronë e manastirit.⁷ Të gjithë Vllehët që përmenden në feudet e manastireve të Serbisë mesjetare ishin, pra, vllehë të sundimtarit, të cilët ai i ndante nga vllehët e tij dhe përmes kartave ua dhuronte manastireve së bashku me obligimet e tyre. Përfaqësues i përgjithshëm i vllehëve në feudet e manastireve ishte igumani i manastirit.

Të dhënat e para mbi vllehët në Serbinë mesjetare gjenden në kartën e Stefan Nemanjës të viteve 1198-1199, me të cilën ky sundimtar i ndante apo i dhuronte manastirit të Hilandarit (në mes tjerash), edhe „*i od Vlah Radovo sudstvo i Djurdjevo, a vsega vlah 170*”.⁸ Termi „sudstvo” që na del në këtë dokument më nuk zihet në ngojë dhe si i tillë është me origjinë sllave. Ky term sikur na bën të mendojmë se vllehët deri në shek. XII nuk kishin organizim të tyre të posaçëm, por atyre iu ishte imponuar organizimi nga ana e shtetit. „Sudci” përmenden ndër vllehët e Kroacisë edhe në shek. XV,⁹ pozita e të cilëve është e qartë.

Krisobula e mbretit Millutin dhënë manastirit të Banjskës në mes të viteve 1314-1316, veç tjerash, ka të dhëna edhe për 9 katunde („katune”) vllehe, të cilat mbreti i dhuron manastirit në fjalë. Ato katunde ishin: *Pijainci* me 52 shtëpi (prej tyre 14 bashkësi të mëdha familjare);¹⁰ *Shishatovci* me 97 shtëpi (prej tyre 12 bashkësi të mëdha familjare); *Bëllgarski* me 39 shtëpi (prej tyre 7 bashkësi të mëdha familjare); *Barilevski* me 65 shtëpi (prej tyre 14 bashkësi të mëdha familjare); *Proillovci* me 9 shtëpi (prej tyre 2 bashkësi të mëdha familjare); *Ursullovc* me 46 shtëpi (prej tyre 6 bashkësi të mëdha familjare); *Bobojevci* me 38 shtëpi (prej tyre asnjë bashkësi e madhe (familjare); Smudirogu me 105 shtëpi (prej tyre asnjë bashkësi e madhe familjare dhe *Vojsillci* me 53 shtëpi (prej tyre 3 bashkësi të mëdha familjare). Në këtë feud të këtij manastiri kishte gjithsej 504 shtëpi vllehësh (prej tyre 58 bashkësi të mëdha familjare).¹¹

⁶ M. Filipovič, *Struktura i organizacija srednjovekovnog katuna*, Simpozijum o srednjovekovnom katunu, Sarajevo, 1963, 66-67.

⁷ K. Jireček, *Istorija Srba*, III, 1923, 115.

⁸ Fr. Miklošich, *Monumenta Serbica*, Viennae, 1858, 4-6.

⁹ *Monumenta historico-juridica Slavorum, meridionalium* VI, Zagreb 1896, 132-133.

¹⁰ Numrin e familjeve e kemi marrë nga M. Filipovič, *pun. i cit.*, 67.

¹¹ M. Filipovič, *pun. i cit.*, 67.

Krisobula e njohur e manastirit të Deçanit nga viti 1330. i dhuron këtij manastiri edhe 7 katunde vllhësh dhe një katund Arbëneshësh („Arbanasa”) apo shqiptarësh.¹² Ato janë:

Katundet	Numri i shtëpive sipas St. Novakoviçit	Numri i bashkësive të mëdha familjare sipas St. Novakoviçit
<i>Ratishevc</i>	17	3
<i>Sushiqani</i>	29	6
<i>Vardishtani</i>	12	/
<i>Llepcinovci</i>	18	8
<i>Tudoriqevci</i>	29	11
<i>Gjurashevc I</i>	16	4
<i>Gjurashevc II</i>	20	5
<i>Arbanaški katun</i>	29	11
G j i t h s e j t:	170	48

Perandori Dushan përmes kartës apo diplomës së vitit 1348 i dhuron manastirit të Shën Arhangjellit këto katunde vllhësh:

Katundet	Numri i shtëpive sipas St. Novakoviçit	Numri i bashkësive të mëdha familjare sipas St. Novakoviçit
<i>Blatqani</i>	87	63
<i>Guncati</i>	75	42
<i>Golubovci</i>	36	3
<i>Kostrçani</i>	68	35
<i>Sinainci</i>	33	17
<i>Jançishta</i>	32	13
<i>Pinushinci</i>	36	22
<i>Dragolevci</i>	80	15
G i t h s e j t:	447	210

Sipas llogarisë së St. Novakoviçit, në kuadrin e tri feudeve: të Banjskës, të Deçanit dhe të Shën Arhangjellit, të cilët shtriheshin kryesisht në territorin e sotëm të Kosovës, kishte 1121 shtëpi vllhësh. Në mesin e tyre kishte 316 bashkësi të mëdha familjare ose 28,2% të tërë familjeve.¹³

Pas St. Novakoviçit, një analizë të hollsishtme, lidhur me numrin e shtëpive të vllhëve në gjirin e feudeve të zëna nga një nga ato, e bëri (sipas të dhënave të tri diplomave të feudeve në fjalë) M. S. Filipoviçi. Rezultatet e tij në këtë drejtim duken kështu:

¹² Mbi këtë katund shqiptar-esh shih kapitullin shqiptarët neper Ishafra.

¹³ St. N o v a k o v i ç, *Selo*, 205-248.

Katundet	Shtëpi	Shtëpi pa djemë (meshkuj)	Shtëpi me djem (meshk.) dhe me fëmijë	Shtëpi me vëllezër
Feudi i Banjskës				
<i>Pijainc</i>	53	1	36	—
<i>Shishatovac</i>	97	14	36	—
<i>Bugarski</i>	39	1	29	—
<i>Barolevski</i>	60	41	6	—
<i>Proillovci</i>	10	6	—	—
<i>Ursultovc</i>	46	20	8	—
<i>Bobojevc</i>	31	24	1	—
<i>Smudirog</i>	105	102	1	—
<i>Vojsille</i>	55	3	43	—
Gjithsejt:	496	212	160	—
Feudi i Deçanit				
<i>Arbanashki katun</i>	29	4	6	19
<i>Ratishevc</i>	18	1	9	8
<i>Sushiqani</i>	29	3	7	19
<i>Llepqinovci</i>	18	1	3	14
<i>Tudiriqevci</i>	29	4	7	18
<i>Govneqije</i>	35	11	9	15
<i>Gjurashevc I</i>	16	4	3	9
<i>Gjurashevc II</i>	20	5	6	9
Gjithsejt:	206	34	59	113
Fundi i Shën Arhangjelit të Prizrenit				
<i>Bllaçani</i>	87	4	23	60
<i>Guncati</i>	82	1	28	43
<i>Janqishta</i>	32	2	7	23
<i>Gollubovci</i>	36	1	15	20
<i>Kostërçani</i>	66	7	18	51
<i>Sinqinci</i>	30	—	14	16
<i>Pinushinci</i>	34	—	12	22
<i>Dragolevci</i>	80	18	22	40
Gjithsejt:	447	33	139	275
Pagarushanët e Deçanit	29	3	11	15
Gjithsejt në të tri feudet	1178	282	369	527

St. Novakoviqi vërtetoi se kushtet në Serbinë mesjetare nuk ishin të përshtatshme për zhvillimin e bashkësive të mëdha familjare, sepse organizimi i atëhershëm shtetëror e shoqëror ishte në kundërshtim me institucionin e familjeve të mëdha, por megjithëkëtë kishte familje të mëdha.¹⁴ Një numër edhe me të madh familjesh të tilla të mëdha gjeti, siç pamë, M. S. Filipoviqi. Sipas këtij rezultoni se në kuadrin e feudeve: të Deçanit, të Arhangjellit dhe të Banjskës, kishte gjithsejt 1178 shtëpi vllhësh, duke llogaritur në këtë numër edhe katundin e arbëneshëve prej 29 shtëpish.¹⁵ Meqë dihet se pjesa më e madhe e territorit të sotëm të Kosovës, e natyrisht edhe katundet vllhe që përmenden në to, atëherë arrijmë deri në përfundim se në këtë territor, në gjysmën e parë të shek. XIV kishte afro 1000 shtëpi vllhe. J. Piç, ndërkaq, mendonte se në trevën e Kosovës, në rrethinën e Shkupit dhe në Shqipërinë e Veriut, kishte në atë kohë 800 shtëpi vllhe, kurse Emillo Fisheri shfaqte mendimin se në Serbinë Nemanjiçase dhe në Shqipërinë e Veriut mund të kishte 12000 vllhë.¹⁶

Na thotë mendja se numri i vllhëve ishte shumë më i madh se numri i atyre që del në dokumente të shkruara, aq më parë kur dihet se kishte vllhë edhe në ato vise e vendbanime për të cilat heshtin burimet e shkruara.

Antroponimia e katundeve vllhe të zëna ngojë më sipër është mjaft interesante. Ajo është vllhe, sllave dhe shqipe. Janë për t'u vënë në dukje rastet kur brenda për brenda një familje perdoreshin emra vllhë, sllavë e shqiptarë.

Kështu psh. në fshatin *Ratishevc* të Feudit të Deçanit, një familje ka këta antarë: „*radoslav a brat me radomir i hran a otac im leš*”.¹⁷ Nga kjo shihet se i ati në këtë familje kishte emër shqip apo karakteristik për shqiptarë, ndërsa bijtë e tij bartnin emra sllavë (serbë). Kjo gjë sikur na bën të mendojmë se e tërë kjo familje ishte shqiptare. Por, me këtë nuk përjashtohet mundësia se ajo në aspektin etnik ishte vllhe, antarët e së cilës kishin futur në përdorim antroponime shqiptare e vllhe.

Kemi raste kur në gjirin e një familje hasim emra sllavë, vllhë e shqip jo vetëm nëpër katundet e Feudit të Deçanit, por edhe nëpër ato të Arhangjellit. Kështu, në diplomën e manastirit të Arhangjellit regjistrohen të gjitha antroponimet e Vllhëve „*blatçane*”,¹⁷ të cilat janë sllave, vllhe e shqipe apo karakteristike për shqiptarë. Prandaj, nëse antroponimia merret si kriter i përcaktimit të përkatësisë etnike të banorëve të atyre vendbanimeve të këtyre feudeve që në dokumente cilësohen si katunde vllhësh, atëherë del se në mesin e tyre kishte sllavë (serbë), vllhë dhe shqiptarë. Mirëpo, kjo mënyrë e përcaktimit të përkatësisë etnike nuk është e sigurtë dhe nuk mund të zbatohet për shkak se injorojmë kushtet

¹⁴ Po aty.

¹⁵ M. Filipoviqi, *Pun. i cit.*, 67-68.

¹⁶ Jos. Lad. Piç, *Über die Abstammung der Rumanen*, Leipzig, 1888, 57.

¹⁷ St. Novakoviqi, *Zakonski spomenici*, 421.

apo rrethanat në të cilat jetonin këta vlllehë, nën ndikimin e të cilave ata mund ta perdornin edhe antroponiminë e huaj.

Vlllehët në trollin e sotëm të Kosovës, në gjysmën e parë të shek. XIV përmenden edhe në fshatin Ponesh. Në kartën apo diplomën e Dushanit të vitit 1348, zihet ngojë *Ponisha e Moravës* me popullatën vllehe.¹⁸

Në udhëpërshkrimin e Kuripeshiqit nga viti 1530 *Poneshi* përmendet si *Poneshi i Sipërm* (Ober Ponesha). Tani në këtë fshat ka shqiptarë dhe serbë.¹⁹

Burimet turko-osmane dëshmojnë praninë e vlllehëve jo vetëm në rrethinat e *Nikshiqit, Smederevës, Braniçevës, Vidinit, Krushevcit, Zvornikut, Rudnikut, Moravës e Sjenicës*, por edhe në viset përreth *Pejës, Prishtinës dhe Prizrenit*.²⁰ Kështu, sipas defterit të xhizjës nga *Cumade-ula sene 896* (12. III. 1491), pra më pakë se gjysëm shekulli që kur kishte përfunduar pushteti serb, Vilajeti i Prishtinës numronte 784 shtëpi dhe 86 „bive” vlllehë, kurse vilajeti i Pejës (Ipek) 914 shtëpi dhe 94 „bive” vlllehë. Gjithësejt në këto dy vilajete në vitin 1491 kishte 1698 shtëpi dhe 170 „bive” vlllehësh.²¹ Nuk ka dyshim se këto 1698 shtëpi që në këtë dokument cilësohen si vllehe nuk ishin të gjitha vllehe edhe në kuptimin etnik. Në të vërtetë, duhet pasur parasysh se termi *Iflak* dmth. vllah i këtij defteri e edhe i regjistrimeve e dokumenteve tjera turke, nuk përfaqëson vetëm vllahin e kulluar për nga përkatësia etnike. Ky term, pra, përfaqëson të tërë numrin e atyre familjeve që në këtë kohë merreshin kryesisht me blegëtori, e në mesin e tyre ishte një numër i konsiderueshëm, që padyshim ishin grup etnik vlllehë. Ky term, pra, përfaqëson statusin e posaçëm shoqëror të asaj pjese të popullatës, që kryesisht merrej me blegëtori, e që në fillim ishte vllehe, po që më vonë me kalimin e kohës përfshin në gjirin e saj edhe etnose të tjera, e sidomos blegëtorë shqiptarë, statusi shoqëror i të cilëve ishte mjaft i afërtë me pozitën e saj në shoqërinë e atëhershme.

Statusi i posaçëm shoqëror i vlllehëve të territorit të sotëm të Kosovës gjatë kohës së ekzistimit të pushtetit serb mesjetar si duket u trashigua edhe për një kohë të gjatë në kohën e vendosjes dhe të dominimit të pushtetit turko-osman, në atë formë të institucionalizuar siç është rasti, fjala vjen, edhe me trashigimin e statusit të posaçëm shoqëror të sasëve nga perioda e para pushtimit osman, dmth. nga koha e pushtetit serb.

Regjistrimi i hollësishëm turk i trevës së Brankoviçëve, dmth. i pjesës më të madhe të trollit të sotëm të Kosovës, nga viti 1455, kur këtu vendoset definitivisht pushteti osman, përmban në mes tjerash edhe aso të dhëna antroponimike që na mundësojnë të arrijmë në përfundim se as në këtë kohë në këtë truall nuk mungonte elementi vllleh. Antroponimet që dëshmojnë këtë gjë janë:

¹⁸ A. Uroshević, *Novobrdska Kriva Reka*, 47, 65.

¹⁹ *Po aty*.

²⁰ Baldiceanu, *Timok...*, 125. A. Cvetkova, *Za etničeskija i Demografskija oblik na Vidini pre: XV.. Izvestia na etnografskija institut i muzei. t. VII. Sofia. 1964. 11-24.*

Nahija	Fshati	Antroponimet vllehe, karakteristike për vllhë, dhe cilësimet etnike që kanë të bëjnë me vllhët	Faqja e def- rit të botuar (Oblast Bran- kovića...,
1	2	3	4
Trgovishte	Shavqe	Rahaqi, i biri i Vinariqit, Radivoji i biri i Rahaqit	4
„ „	Naboj	Radovac-i, vllah	6
Kllopotnik	Tushimle	Vllkac, blegëtor (pastir)	10
„ „	Crnokrpi	Gjorgje, blegëtor	16
Dollci	Drstnik	Llujqi, bari xnj (ovçar); Radovan, i biri i bariut (çobanit)	20
„ „	Qiranik	Bozhidari, i biri i bariut (govedar)	23
„ „	Shtitarica	Raja, bari (ovçar)	25
„ „	Vllçitërn	Stepani, lëkuraxhi (kožuhar), Vllkota, vëllau i tij, Radisllavi, lëkuraxhi (kožuhar), Radihna lëkuraxhi, Todori, lëkuraxhi, Rajini, lëkuraxhi, Radulli, i varfër	29
„ „	Shitarica	Pop Radullin, Radovani, lëkuraxhi	31-32
Morava	Grabovac	Trajko-ja, i biri i vllahut, Gjorgje, vëllau i tij, Marko i biri i vllahut	33
„ „	Vurtak	Radoje, i biri i Stjepanit, Radovaci i biri i tij	36
„ „	Banjica	Dane, i biri i Llugreshës, Dragoshi, i biri i Llukarit	38
Vuçitërn	Maguri	Rajani, i biri i Radullit, Radisllavi, i biri i tij, Bogdani, i biri i tij, Lubisha, i biri i Rajanit, Perihna, vëllau i tij	45
„ „	Vërbnica	Radulli, i biri i Ostojës	52
„ „	Klladorednica	Bogdan, vllah	64
„ „	Radishevo	Vallkashin, vllah	67
„ „	Trstenik	Vojini, i biri i Radullit, Stanimiri, i biri i vllahut	73
„ „	Bezhanik	Dimitras, vëllau i tij, Radisllavi, vëllau i tij, Bozhidari i vëllau i tij, Raleta, i biri i Shishmanit	74
„ „	Godance	Radisllavi, vllah	77
„ „	Dolni Brgari	Vllashko, i biri i Smiles	82
„ „	Nuk është i shënuar emri i fshatit	Stojani, i biri i vllahut, Radullin Tvrdisllav	93-94
„ „	G. Brkovac	Bogovac, vllah	98
„ „	G. Kostomll.	Petko, vllah, Bozhidari, i biri i tij	102
„ „	Prudina	Radovani, i biri i Surdullit, Radku, vëllau i tij, Dimitrashini, vëllau i tij	
„ „	Stërmac	Vëllkashini, vllah, Radica, i biri i tij, Radovani, vëllau i tij	106
„ „	Kollo	Radulli, vëllau i tij	
„ „	Vërba	Stepani i biri i vllahut, Dabizhivi vëllau i tij, Rakoje, i biri i tij	109
„ „	Plleshino	Dançulli, i biri i Kojillës	109
Morava	G. Nerodimle	Stojko, i biri i vllahut, Stepici i biri i Dançullit	123
„ „	Harance	Duka, vllah,	122
„ „	Sharanik	Niksha, prishllac, Dimitri, i biri i tij, Ivko, vllah	128
			129

1	2	3	4	
„	„	Ribnik	Vlladisllavi, blegëtor	132
„	„	Billastena	Nenada, i biri i vllahut	143
„	„	Blladci	Rade, i biri i Dragullit	151
„	„	Stuboll	Gjura i vëllau i tij	156
„	„	Zagradi	Petko, vllah, Vlladisllavi, vëllau i tij	156
„	„	Opashtica	Rahoje, i biri i vllahut, Konstandini, vëllau i tij	157
„	„	Tërstenik	Bullajin, vllah	160
„	„	Zhapina	Juvani, i biri i vllahut, Nikolla vëllau i tij	160
„	„	Seferiqina	Braneshi, i biri i Radshinit	163
„	„	Përcas	Mërksha, vëllau i tij, Bratulli, vëllau i tij	163
„	„	Gorn. Pudnik	Radull	164
„	„	Babusha	Dabizhivi, i biri i Dançullit, Nikolla, i biri i tij	165
„	„	Priboj	Ostoja, primiqur, Branko, i vëllau i tij, Vllajka, vëllau i tij	169
„	„	Karim	Radullini, i biri i Grubanit	173
„	„	Topilla	Jovani, i biri Rajanit	180
„	„	Kllokot	Bogdani, vllah, Petko, i biri i tij	181
Topollnica	„	Pasjan	Rakulli, i biri i tij	184
„	„	Dolja Gush.	Vellomir, vllah, Babizhivi i biri i tij	187
„	„	Ulfeginjët e kështjellës së Novobërdës	Dogan, eflak, Ismail, eflak	209
„	„	Llepina	Radulli, i biri i Bogosllavit	215
„	„	Hllaple	Mihailli, i biri i vllahit, Gjura, i biri i vllahut	217
„	„	Dobrodubko	Vëllkashini i biri Balliqit Shishmani, i biri i Dabizhivit	219
„	„	Batus	Vllahu, vëllau i Milloshit	223
„	„	Homoshtica	Radisllavi, i biri i Bullatit	231
„	„	G. Rushince	Vllahu, i biri i Prijezdës	233
„	„	Dollovac	Radica, i biri i vllahut	239
KAB	„	Vërban, i përket Moravës	Vojini, vllah, Vëllkosllavi, i biri i tij, Dimitriji, i biri i tij	246
„	„	Petrilla	Dançulli, i biri i Radotës	254
„	„	Ballin Potok	Dançulli, i biri i Novakut	273
„	„	Lluzhan	Petko, i biri i Dançullit	287
„	„	Vidre	Radica, i biri i Dançullit, Bogdani i biri i Dançullit	290
„	„	Dobratin	Radulli, i biri i Bratiqit, Dimitrije, vllah, Stanisha, i biri i Llajoshit	302
„	„	Braina	Bogdani, i biri i vllahut, Radivoji, i biri i tij, Radica, i biri i tij, Radovani, i biri i tij	321

Duke pasur parasysh faktin se të dhënat antroponimike të shënuara në tabelën e sipërme rrjedhin nga viti i parë i vendosjes së pushtetit turko-osman, kur akoma nuk kishin ndodhur migrime me përmasa të mëdha, atëherë mund të përqafohet mendimi se ata vllahë që qëndrojnë prapa këtyre antroponimeve vllahë apo karakteristike për vllahë ishin banorë të këtyre vendbanimeve edhe në kohën e ekzistimit të pushtetit serb të mesjetës. Sipas të gjitha gjasave, këta paraqesin një pjesë të mirë të

trashëgimtarëve të atyre vllihëve që na dalin në dokumentat qirilike të gjysmës së parë të shek. XIV., aq më parë kur nga kjo kohë e deri në mesin e shek. XV, për një kohë prej afro një shekullit, ishte kryer me të madhe edhe procesi i territorializimit të katundeve si vendbanime blegëtorësh.

Të dhënat e tabelës së sipërme dëshmojnë gjithashtu se vllihët e shekullit XIV nuk ishin asimiluar aqë shumë, ndonëse është e pabesueshme të mendohet se te ta nuk ishte ndier procesi i shkrirjes së tyre në etnose të tjera që ishin më dominante qoftë për nga numri, qoftë përnga pjesëmarrja në pushtet dhe në kishë.

Këta vllihë nuk arrijnë të shkrihen krejtësisht as një shekull më vonë, ndonse nga procesi i asimilimit e ndoshta, edhe nga procesi i migrimit, numri i tyre në gjysmën e dytë të shek. XVI reduktohet mjaft shumë. Kjo gjë del qartë nga të dhënat antroponimike të një defteri të hollësishëm të sanxhakut të Vuçiternës nga gjysma e dytë e shek. XVI. Këto të dhëna që dëshmojnë praninë e vllihëve në sanxhakun e përmendur në gjysmën e dytë të shek. XVI janë:

Nahija	Fshati	Antroponimia që dëshmon praninë e vllihëve	Faqja e defit. (Tapu ve kadastro ümüm müdürlüğünün Arsihi Ankara nr. 124)
1	2	3	4
Obisin	Obiliq	Dobrosav Radull	7
Gllama	Llushnan	Neshko Radull	18
„ „	Gërbavica	Petko Radull	31
Lleskovac	Trebanje	Marko Vanqull	36
Bane	Vllah	Antroponimia e këtij fshati që ka për bazë emrin etnik Vllah është kryesisht serbe e krishterë, por ka edhe antroponime të tilla që kanë formë shqipe.	38
Petollnica	Prijovca	Nikolla Vllah, Joshe Vllah	67
„ „	Kërstina	Mihajllo Radull	75
„ „	Konçull	Llukaq Dançull	84
„ „	Radullovcë	Cvetko Radull	87
„ „	Mezra Vllahotinca	—	93
Llab	Besni Prag	Bashtina e Radullit që gjendet në dispozicion të Radosav Stefanit	130
„ „	Dollna Dubnica	Bashtina e Danqullit...	132
„ „	Ballin Potok	Bashtina e Petko Stepan Danqullit	136
„ „	Perrnica	Bashtina e Vllahut që gjendet në dorën e Luke Rajkos	139
„ „	Bukariqina?	Nikolla Radull	143
„ „	Konjishovce	Ilija Radull	152
„ „	Dobrotin	Nikolla Radull	176
„ „	Olar	Danqull Bozhidar	181
Gollak	Mezra	Pa emra vllihë	189
„ „	„Gorno Urlani“		
„ „	Iflak		

1	2	3	4
„ „	Komaj	Vllah Marko	196
„ „	Qurla	Done Danqull	201
„ „	Medenica	Mati Radull	203
Vuçitërnë	Vllahinja	Pa emra vllahë	225
„ „	Babinos	Bashtëina e Vllahut	229
„ „	Kozhince	...Radull	237
„ „	Gorno Verbovce	Pop Radull	238
„ „	Gornje Tërnovce	Pavell Radull	268
„ „	Crni Vërh	Radull Bogdan	277
Kllopotnik	Breinovo	Radull Pop, Grujo Radull, Pavell Radull	286

Është për të vënë në dukje se në faqen 318 të këtij defteri përmendet njëfarë *Gjore Vllah* nga qyteti i Prishtinës, sikurse në faqen 331 vllëhet e fshatit Ribar të rrethit të Prizrenit.²²

Regjistrimi i hollësishëm turk (osman) i vitit 1591, në mes të tjerash, na ofron edhe të dhëna të tilla në bazë të të cilave shihet prania e vllëhëve në Prizren, në Rahovec në nahinë e Hoçës dhe në rrethinat e tyre. Të dhënat antroponimike që dëshmojnë praninë e tyre në këtë nahinë e Hoçës, janë: *Stojko Dimitru, Aleksi Dimitru, Stepan Dimitru, Stojan Dimitru, dhe Dabizhiv Dimitru*, nga Hoça; *Kojo Dimitru* nga fshati Slamodrzha; *Marko Dimitru, Stepan Dimitru* nga fshati Ofterusha; *Radovan Dimitru, Jovan Dimitru, Radiq Dirmitru, Petko Dimitru*, nga fshati Mirushë; *Marko Dimitru*, në fshatin Samopesë dhe *Radiq Dimitru, Radosav Dimitru* në fshatin Popoviq.²³

Se këta kryefamiljarë ishin me origjinë vllëhe del qartë nga nyja karakteristike rumune që përdoret me rastin e shquarsisë së antroponimeve të tyre, e të cilët dëshmojnë se formimi i mbiemrave të tillë pa përdorimin e vllahishtes ishte krejtësisht i pamundur.

Duhet ditur se numri i vllëhëve ishte pas gjithë gjasash më i madh se numri i këtyre antroponimeve e patronimeve të shënuar më sipër, sepse është e pamundur të përcaktohen të gjitha ato antroponime që përfaqësonin elementin vllëh. Antroponimet e sipërme, ndërkaq, dëshmojnë vetëm rastet, më karakteristike të këtyre vendbanimeve ku del qartë përdorimi i njëjës shquese të rumunishtës apo të vllahishtës së atëhershme.

Praninë e një numri të vogël vllëhësh në rrethinën e Kaçanikut, në mes të viteve 1467-68, e provon edhe regjistrimi detaj turko-osman i po këtyre viteve: *Miloshi i biri i Danqullit* nga fshati Gjurgjevdoll, *Bozhidari i biri i Radullit*. *Rudini i vëllai i Radullit* nga fshati Ninkovce dhe *Rankulli (Rajkull)*, i biri i *Bogdanit* nga fshati Llanishtë.²⁴

Të gjitha antroponimet e shënuara deri më tash e të nxjerra nga defterë turqë të shekullit XV-XVI, e kundërshtojnë pohimin e Dr Sima

²² Topue kadastro umum müdürlüğünün arsivi Ankara, defter nr. 124, d. 318. 331.

²³ Tapu ve kadastro umum müdürlüğünün arsivi, defter nr. 55. defter-i mulassal liva-i Prizren. F. 50-79.

²⁴ Opsiren popisen defter nr. 4, Skopje, 1971.

Qirkoviqit se vllhët deri në fund të mesjetës (paraturke) ishin sllavizuar në aspektin gjuhësor.²⁵ Gjithashtu, këto të dhëna burimore të karakterit antroponimik dëshmojnë se kishte vllhë që jetonin jo vetëm nëpër vendbanime blegëtorësh (nëpër katunde), por edhe nëpër vendbanime me karakter bujqësor, nëpër fshatra. Se ky konstatim që mund të nxirret në bazë të të dhënave të burimeve turko-osmane është i drejtë dhe i qëlluar mund të shihet edhe nga fakti se në dokumente të shekullit XIV dalin vllhë, që jetonin nëpër vendbanime joblegëtorale. Shembëll tipik në këtë drejtim është fshati Çabiq i Feudit të Deçanit, në të cilin përmendet: „*Vlah Dobromir sa sinovima Slavom Budislavom, Novakom, Bratilom, Vojihnom i Hranislavom*”. Po kështu në fshatin *Brodliq*, afër Deçanit, del njëfarë „*Radislav Vlah*”,²⁶ Në gjysmën e parë të shekullit XV konkretisht në mes viteve 1432-38, në fshatin Podragjë, jo shumë lag Novobërdës, zihet ngojë „*Radiq Vlah*” nga Shtimja.²⁷

Të dhënat antroponimike nga defterët turq të shekujve XV e XVI, që zënë vend në tabelat e sipërme na mundësojnë të shohim se vllhët në këtë kohë nuk ishin vetëm blegëtorë, nuk jetonin vetëm ndër vendbanime të pasura me pyje e kullosa, në të ashtuquajtura „*katune*” të dokumentacionit të kohës, siç është menduar deri tash dhe siç mendohet edhe sot e gjithë ditën, por ata jetonin edhe nëpër ato vendbanime ultësinore e rrafshinore në të cilat si degë kryesore ishte bujqësia. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se shumica e tyre nuk merreshin me blegëtori. Nga kjo vetvetiu rezulton se kishte vllhë (në territorin e sotëm të Kosovës) që jetonin nëpër vendbanime blegëtorale, nëpër katunde, që kryesisht merreshin me blegëtori, por kishte edhe vllhë që jetonin nëpër vendbanime bujqësore, nëpër fshatra dhe nëpër qytete. Ata që jetonin në fshatra kishin si profesion bujqësinë, kurse ata që ishin ngulitur në qytete, përveç bujqësisë mund të merreshin edhe me ndonjë zeje, e edhe të zinin ndonjë vend në hierarkinë e administratës të pushtetit dhe të kishës.

Njësia kryesore shoqërore organizative e Vllhëve që merreshin me blegëtori ishte *katundi*, i cili përbëhej rëndom prej disa dhjetra shtëpish. Katundet kishin të parët e tyre që ishin përgjegjës (të katundit) para pushtetit.²⁸ Të parët e vllhëve ishin: *Prijsi (knez)*, *Primiçuri*, *Llagatori* dhe *Tekligji*.²⁹ *Prijsi* ishte në krye të një territori apo të një njësie territoriale. Të tillë pati psh. Smedereva. Si i dyti në hierarkinë vllhe ishte *primiçuri*, i cili del edhe në disa vendbanime (katunde) të shekullit XIV të trollit të sotëm të Kosovës. Në dokumentet qirilikë të shekullit XIV shpesh si të parë të fshatarëve, shfaqen *prijsi* dhe *primiçuri*. Në pamje të parë del sikur kemi të bëjë me dy sinonime, aq më parë kur në kartën e Shën Arhangjellit të Prizrenit del të përmendet 4 herë *primiçuri* e një herë *prijsi*.³⁰

²⁵ Enciklopedija Jugoslavije, 7 Zagreb, MCMLXVIVII, 506.

²⁶ M. Milojević, *Dečanske hrisovulje*, 24, 99- 59-60.

²⁷ M. Dinić, *Iz Dubrovačkog arhiva*, I, Beograd, 1957, 69.

²⁸ M. Filipović, *pun. i cit.*, 83.

²⁹ Shih: N. Beldiceanu, *Sur les Valaques des Balkans slaves a l'epoque ottomane (1450-1550)*. Revue des Etudes islamiques XXXIV, Paris, 1966, 83-132.

³⁰ Glasnik SUD XV, 289.

Krisobula e Manastirit të Deçanit e vitit 1330 nuk ka kurrfarë të dhënash mbi të parin e katundit. Përshkrimi i saj ndërkaq, nga koha e Dushanit, ka prijsin e katundit *Sremlan*.³¹ Përndryshe, prijsi përmendet që më 1220 në diplomën e Zhiqës.

Në periodën e sundimit turk bëhet gjë e zakonshme ekzistimi i prijsit apo i primiçurit si të parë të vlllehëve.

Prijsat, pra ishin kujdestarë (të parët) e vërtetë të grupeve vllehe të rangjeve të ndryshme, me kusht që prijsi ishte në të njëjtën kohë edhe kujdestari i katundit të vetë, të cilit i përkiste, ndërsa kujdestarët (të parët) e rëndomtë të disa katundeve në territoret juglindore ishin primiçurët. Për këtë arsye primiçuri përmendet më shpesh në diplomën e vitit 1348.³² Ligjet turke provojnë se prijsat e primiçurët nuk ishin të njëjtë, primiçurët i nënshtroheshin (vareshin) prijsave në sistemin hierarkik.³³ Origjina e termit primiçur, sipas K. Jirečekut, është romake.³⁴

Në katundet vllehe është raritet që gruaja të jetë kryesuese e familjes. Nga 496 shtëpi vllehe të manastirit të Banjskes, kemi vetëm tri raste kur gruaja përfaqëson familjen.³⁵ Në mesin e 25 shtëpive vllehe të manastirit të Graçanicës, vetëm një shtëpi ka si kryefamiljar gruan.³⁶ Posaçërisht është interesant se në katundin e arbëneshëve („Arbanasa”) të feudit të Deçanit, e as në katundet vllehe të feudit të Arhangjellit të Prizrenit, nuk kemi raste që gruaja ta përfaqësoj familjen.³⁷

Tretmani i primiçurëve në kohën e sundimit osmano-turk ishte i njëjtë me atë të timariotëve (spahinjëve).³⁸

Të dhënat burimore mbi legatorët dhe mbi tekligjet janë shumë të varfëra dhe njohurit për ta janë tejet sipërfaqësore.

Vlllehët kanë pasur status shoqëror të posaçëm edhe në kohën e pushtetit turko-osman.³⁹

Burimet e njohura deri më tash nuk kanë kurrfarë të dhënash lidhur me atë se si dikush bëhej i pari i katundit, dmth. nuk dihet se a emroheshin apo zgjedheshin dhe kush e bënte këtë gjë. Por, një gjë del e qartë nga burimet ekzistuese: përfaqësuesit apo të parët e katundeve në të shumtën e rasteve ishin nga bashkësitë e mëdha familjare. Një gjendje e këtillë mbretëronte në Feudin e Deçanit, ndërsa në Feudin e Arhangjellit nuk dihet se si qëndronte puna në këtë drejtim, sepse në dokumentin e këtij feudi regjistroheshin vetëm kryefamiljarët.⁴⁰ Duke u mbështetur në këto njoftime që na ofrojnë dokumentet e kohës, M. S. Filipoviçi arrin në përfundim se prijsat

³¹ A. Solovjev, *Odabrani spomenici...*, 19-20.

³² M. Filipović, *pun. i cit.*, 84.

³³ B. Gjurgjev, *Nešto o vlaškim starešinama pod turskom upravom*, Glasnik Zemaljkog muzeja XLII, Sarajevo 1940, 49-50; H. Inalçik, *Od st. Dušana do Osmanskog carstva*, POF, III-IV, Sarajevo, 1953, 34-35.

³⁴ K. Jireček, *Istorija Srba*, III, 115.

³⁵ *Spomenik*, IV, 8-9.

³⁶ A. Solovjev, *Odabrani Spomenici*, 103.

³⁷ M. Filipović, *pun. i cit.*, 73.

³⁸ N. Beldiceanu, *Sur les Valaques...*, 103.

³⁹ *Po ary*.

⁴⁰ *Glasnik XV*, 291-295.

*e katundeve nuk i zgjidhte askush e as nuk i caktonte apo emronte, por individëve të pasur e me autoritet i besonte vetë rrethi dhe i njihje për të parë apo prijisa.*⁴¹

Deri në kohën tonë, në dijen e historisë, është rrahur mjaft kuptimi i termit Vllah. Ka pasur raste që disa studjues të orvaten që në çdo mënyrë të provojnë se vetëm në shekullin e parë të sundimit të Nemanjiçasëve ky term përfaqësonte edhe vllahun në kuptimin etnik, ndërsa në shekujt XIV e XV përfaqësonte serbin që merrej me blegëtori. Kështu, psh. St. Novakoviç,⁴² e më tepër L. Stojanoviç⁴³ i dilyn zot mendimit se termi vllah në Serbinë mesjetare të Nemanjiçasëve nuk përfaqësonte kurrëfarë kombësie, por vetëm status shoqëror. Pohimi i tyre, ndërkaq, se me termin vllah në shekujt XIV e XV nuk përfshihej edhe popullata vllahe në kuptimin etnik nuk mund të qëndrojë. Një pohim të këtillë e kundërshtojnë toponimet vllehe të kësaj kohe dhe të dhënat antroponimike të zëna ngojë më lartë. Prandaj, termi vllah në këta dy shekuj përfshinte vllahin që merrej me blegëtori e edhe elementet tjera etnike që bashkëjetonin me të dhe që kishin status të njëjtë shoqëror.

Mendimi i përhapur gjersisht në shumë shkrime të deritashme se Vllehët me pranimin me shumicë të antroponimisë sllave u shkrinë edhe etnikisht dhe u shndërruan në serbë nuk është i qëndrueshëm para kritikës së shëndosh shkencore, sepse jo vetëm vllehët po edhe etnoset tjera me pozitë të ngjashme shoqërore përvetësuan antroponiminë e huaj, por me të nuk humbën edhe karakteristikat specifike etnike. Lidhur me këtë dijetari mjaft objektiv *Ilarion Rucarci*, shkruante: „*Në krisobulat e mbretërve dhe të perandorëve serbë: në ato të Zhiqës, të Banjskës, të Deçanit dhe në të Arhangjellit përmenden vllehët e katundet vllehe dhe në ato katunde, në mesin e vllehëve edhe njerëz me emra vllahë: Bun, Bunillo, Bukor, Berbat, Ballda, Balldovin, Buckat, Alltoman, Dajull, Vlladull, Njegull, Motull, Krecull, Radull, Rashull, Surdull, Hrajull, Kapor, Feqor, Singur, Shishman, Sharaban e shumë të tjerë; e përveç tyre, në mesin e këtyre vllehëve, në katundet vllehe (...) përmenden katër pesë herë më tepër të tjerë me emra të pastër sllavë, apo nëse doni me emra serbë. Dhe tash pyes: a thua vërtetë mund të mendohet se në mesin e atyre njerëzve që quhen vllahë dhe që jetojnë në katundet vllehe vllehët ishin me origjinë romano-vllehe vetëm ata që mbajnë emra vllahë, e të gjithë të tjerët me emra sllavo-serbë, nuk ishin me origjinë romano-vllehe po me origjinë serbe? Dhe nëse vërtetë mendohet kështu atëherë ndërprej çdo fjalë të mëtejme dhe çdo diskutim*”.⁴⁴ Nga kjo del mendimi i këtij dijetari, se vllahë në kuptimin etnik, ishin jo vetëm ata kryefamiljarë të katundeve vllehe që bartnin emra vllahë po edhe ata që kishin emra sllavë (serbë). Prandaj, si të tillë, pavarësisht nga antroponimia

⁴¹ M. Filipoviç, *pun. i cit.* 88.

⁴² St. Novakoviç, *Iz srpske istorije*, f. 88, pohon: „... reč vlah u Staroj Srbiji već u XIII veku značila poglavito red društveni, a ne narodnost”.

⁴³ Lj. Stojanoviç, *Pristupna akademska beseda*, Glas SKA, LII, drugi razred, 34, Beograd, 1896, 24.

⁴⁴ *Zbornik Ilariona Rucarca* (odabrani istorijski radovi) sa 1, Beograd, 1934, 520.

e tyre heterogjene, edhe në aspektin etnik dhe gjuhësor ishin vlllehë. Përndryshe, në publikimet e derisotme është trajtuar edhe problemi se athua vlllehet, që na dalin në dokumentet e shkruara të shekullit XIII-XV, e flisnin akoma gjuhën e tyre apo ishin sllavizuar. Fr. Mikloshiçi mbronte mendimin se ata në këtë kohë kishin ruajtur edhe gjuhën e tyre.⁴⁵ St. Novakoviçi,⁴⁶ duke pasur për bazë antroponimet e shumta sllave që në atë kohë dalin në mesin e tyre, shfaqte mendimin se ata ishin sllavizuar në kohën e themelimit të manastireve të Zhiqes, të Deçanit dhe të Arhangjellit, kurse Konstantin Jireçeku, duke pasur për bazë çfarë thonin dy dijetarët e mëparmë, me maturinë e tij të njohur, shkruante vetëm se në shekullin. XVI në bregdetin kroat flitej romano-vllahishtja,⁴⁷ por nuk thoshte asgjë mbi gjuhën e vlllehëve të territorit të sotëm të Kosovës.

Me problemin e gjuhës së Vlllehëve, mendojmë se është i lidhur ngusht problemi i asimilimit të tyre. Sa i përket asimilimit të tyre është e rëndësishme ndalesa e martesës në mes të vlllehit dhe serbit, përkatësisht pamundësia e kalimit të serbit në statusin shoqëror të vlllehit. Kjo ndalesë është padyshim e karakterit ekonomik e social. Si e tillë fletë qartë se kishte pasur raste të martesës në mes vlllehit e serbit, dhe me të i jipej fund një dukurie të këtillë. Mirëpo është gabim nëse kjo ndalesë konsiderohet si ndalesë me karakter etnik, por duhet kuptuar si ndalesë mbi martesën në mes të serbit apo bujkut dhe në mes të vllahut apo blegëtorit, statusi apo tretmani shoqëror i të cilëve nuk ishte identik. Sidoqoftë kjo ndalesë ka ndikuar padyshim pozitivisht në stagnimin e procesit të shkrirjes etnike të vlllehëve, shumica e të cilave në mesjetë ishte blegëtor. Mirëpo, meqë në gjirin e tyre, sipas të gjitha gjasave pas shekullit XIV kishte edhe elemente etnike të tjera si psh. shqiptarë, e ndoshta edhe serbë, që merreshin kryesisht me blegëtori dhe që kishin tretman të njëjtë shoqëror, atëherë duhet kërkuar shkrirjen e tyre mu në këto elemente. Kjo gjë sikur na tërheq vëmendjen që të mendojmë se a mos pati farë shqiptarizimi të vlllehëve, e kjo gjë është mjaft afër mendësh nëse kemi parasysh këto fakte: aty ku në territorin e sotëm të Kosovës përmenden ndër burime të shkruara të shek. XIV vlllehët, menjëherë pas tyre përmenden edhe grupe shqiptarësh si blegtorë, në katundet vlllehe të manastirit të Deçanit e të Arhangjellit gjejmë, edhepse jo shumë, antroponime karakteristike për shqiptarët mesjetarë; katundet vlllehe që bënin pjesë në trollin e sotëm të Kosovës ishin të rrethuara nga të gjitha anët me popullatë shqiptare që jetonte jo vetëm nëpër katunde po edhe nëpër fshatra bujqësore dhe nëpër qytete; vlllehët u ruajtën në një masë të konsiderueshme edhe etnikisht e gjuhësisht deri me pushtimin turk të këtij trolli, kur me shkatrrimin e pushtetit serb, me dobësimin gradual të ndikimit të kishës për shkak të

⁴⁵ Fr. Miklošič. *Über die Wanderungen der Rumunen in deu dalmatinischen Alpen und der Karpaten*, Wien 1879, Deuschrifteu der kais. Akademie, Bd. 30,3.

⁴⁶ St. Novakovič. Selo, vërejtja nr. 31.

⁴⁷ *Zbornik Kaustantina Jirečeka*, 45-47.

islamizimit, nuk ekzistojnë më mundësi për sllavizimin apo serbizimin e tyre.

Mendimi se vllahët e territorit të sotëm të Kosovës pjesërisht edhe u shqiptarizuan sikur gjen mbështetje edhe në këtë konstatim të Prof. E. Çabejit: „Po shqipja ka edhe disa fjalë rumune jo të burimit arumun, po, si duket, marrë nëpërmes të vllahishtes që flitej në „luginë të Drinit të Zi” në mesjetë. Të tilla janë psh. partalle „rraqe të vjetra” bashkë me shpartallojë „shkatrrojë” nga rum. partal „cubë”, me trasë një lundër „me tërhekë një lundër”, prej rum. tras. „tërhequr”. Këto huazime i ka vënë në dukje N. Jokli”.⁴⁸ Gjithashtu, lidhur me këtë problem, duhet pasur parasysh edhe faktin se para pak kohësh Haralambie Mihaescu, në një punim të tij, trajton albanizmat „(...) që shtegtuan te aromunët (autori, si duket, termin aromun e identifikon me atë vllah) që dëshmohen se më 873 për banorë visesh midis liqenit të Kastorias e atij të Dorjanit.

Në mbështetje të fjalorit të T. Papahaghit, autori heton se në arumunishtën ka 337 fjalë shqipe. Ky pastaj i ndan këto albanizma, sipas sferave të jetës e të punës.

Nga numri i albanizmave e sidomos nga ndarja në sfera të ndikimit, del se shqipja kishte ndikuar në të folët e arumunëve në të gjitha sferat e jetës e të punës”⁴⁹

Muhamet Tërnavë

CONTRIBUTION A LA QUESTION DE LA PRESENCE ET DE L'ASSIMILATION DES VALAQUES A KOSOVË AU COURS DES SIECLES XIV-XVI-e

R é s u m é

Dans cette étude on utilise les données de source de la documentation cirilique et turque-des cahiers (defter) tures concernant la présences des valaques dans le territoire actuel de Kosova au cours des siècles XIV-XVI-e. A l'appui des données qui offrent les sources de ces siècles et avec lesquelles dispose l'auteur on arrive à ces constatations: Les valaques de ce territoire ne s'assimilèrent pas avant l'invasion turque de ce territoire, mais ils se réduchèrent numériquement. Ils sont même présent dans les deux premiers siècles de la domination osmano-turque. Tout cela résulte des données anthroponomiques et de autres preuves des recensements tures. Comme tels, ils n'étaient pas seulement d'habitants des domiciles appelés „katune”, ils n'exerçaient pas seulement l'élevage même si la plupart d'eux exerçaient se métier économique, mais ils habitaient les domiciles appelés „katune”. Le fait que les valaques ne s'assimilèrent pas complètement jusqu'à l'invasion turque du territoire actuel de Kosova permet à l'auteur d'exprimer la pensée d'une albanisation partiele surtout quand le nombre

⁴⁸ E. Ç a b e j, *Studime gjuhësore, III*. Prishtinë, 1976, 78.

⁴⁹ H a r a l a m b i e M i h a e s c u, *Remarque sur les rapports lexicaux albano-aroumains*, Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike, VII (1977), Prishtinë, 1978, 126.

des albanais dans ce territoire au cours de ces trois siècles était beaucoup plus grand que celui des valaques et qu'après l'invasion turque de cette contrée commence la défaillance graduelle de la supériorité de l'église orthodoxe serbe.

Au début, le terme valaque avait une notion ethnique. Il présentait un élément ethnique romain et plus tard, avec ce terme on comprenait la population non-valaque qui exerçait l'élevage. Donc, ce terme représentait le valaque sous la notion ethnique, mais qui exerçait l'élevage et le non-valaque qui exerçait aussi cette branche économique.